



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ)

Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit

Tetor 2016



Përmbajtja

1. Objektivat dhe fushëveprimi	3
2. Termet e përdorura	4
3. Rasti i rregullt i ndërrimit të furnizuesit.....	5
4. Njoftimi për kundërshtim të ndërrimit të furnizuesit.....	8
5. Kontestet.....	10
6. Ndërrimi i furnizuesit në rastet e bankrotimit ose likuidimit të furnizuesit të deritashëm.....	11
7. Ndërrimi i furnizuesit në rastet e revokimit të licencës.....	12
8. Ndërrimi i furnizuesit në rastet kur konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri.....	13



Kjo **Rregull** (duke përfshirë edhe amendamentimet pasuese) është realizuar në përputhje me Nenin 36, të Ligjit (Ligji Nr. 05/L - 085) për Energjinë Elektrike, si dhe në përputhje me Nenin 6 të **Rregullave të Tregut**.

Rregulla për ndërrimin e Furnizuesit

1. Objektivat dhe Fushëveprimi

1.1 Objektivat

1.1.1. Kjo **Rregull** përcakton mënyrën se si një **Konsumator Fundor, Familjar** ose **Jofamiljar** që dëshiron ta ndërrojë **Furnizuesin** e tij mund të transferohet nga **Furnizuesi i Deritashëm** tek një **Furnizues i Ri**.

1.2 Fushëveprimi

1.2.1. Në këtë **Rregull**, do të aplikohen principet vijuese:

- (a) E drejta e çdo **Konsumatori Fundor, Familjar** ose **Jofamiljar** të zgjedhë **Furnizuesin** e tij, duke zbatuar afatet dhe kushtet e caktuara në këtë **Rregull** dhe duke ndërmarrë veprimet e nevojshme nga ana e **Konsumatorit Fundor, Familjar** ose **Jofamiljar, Furnizuesit të Ri, Operatorit të Rrjetit** relevant, **Agjentit për Administrimin e Matjeve (AAM)** dhe **Furnizuesit të Deritashëm** për t'i mundësuar **Konsumatorit Fundor, Familjar** ose **Jofamiljar, Ndërrimin e Furnizuesit**;
- (b) Mundësimi nga **AAM** i **Ndërrimit të Furnizuesit** në përputhje me këtë **Rregull**, afatet dhe kushtet e parashtruara në të;
- (c) Mirëmbajta nga **AAM** e **Bazës së Matjeve** për të reflektuar **Ndërrimin e Furnizuesit**;
- (d) Dorëzimi i njoftimit për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** nga ana e **Furnizuesit të Deritashëm** tek **AAM**, në përputhje me paragrafin 4 të kësaj **Rregulle**;
- (e) Lëshimi i faturës përfundimtare për **Konsumatorin** nga **Furnizuesi i Deritashëm** jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas **Datës së Ndërrimit të Furnizuesit**.



2. Termet e përdorura

- 2.1 **Agjenti për Administrimin e Matjeve (AAM)** - është agjent që themelohet nga **Operatori i Tregut** me përgjegjësitë e parashtruara në paragrafin 5.1.2 të **Rregullave të Tregut**.
- 2.2 **Barazimi përfundimtar** - emërtim i përbashkët për proceset e përdorura për përcaktimin e shfrytëzimit të sistemit të transmetimit nga çdo palë, detyrimet financiare dhe pagesat që rrjedhin nga këto detyrime, si dhe detyrimet e palëve për jobalncet e shkaktuara.
- 2.3 **Data e Ndërrimit të Furnizuesit** - është data në të cilën **Furnizuesi i Ri** bëhet përgjegjës për **Furnizimin e Konsumatorit**.
- 2.4 **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** - është një **Furnizues** i caktuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e **Furnizimit** në kushte të rregulluara ndaj **Konsumatorëve**, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një **Furnizues** ose kanë humbur **Furnizuesin** e tyre.
- 2.5 **Furnizuesi i Deritashëm** - është **Furnizuesi** që aktualisht operon dhe është i regjistruar për **Furnizimin e Konsumatorëve** në **Sistemin Matës** të caktuar.
- 2.6 **Furnizuesi i Ri** - është **Furnizuesi** që dorëzon njoftim se dëshiron të **Furnizojë** një **Konsumator** nga një **Sistem Matës** i caktuar.
- 2.7 **Konsumatori Fundor, Familjar ose Jofamiljar** (në tekstin e mëtejshëm: **Konsumatori**) - është **Konsumatori** i cili është i lirë të zgjedh **Furnizuesin** nga i cili do të blejë energji elektrike në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike.
- 2.8 **Kontrata** - është një **Kontratë** e përmbyllur ndërmjet **Konsumatorit** dhe një **Furnizuesi të Ri**, por që do të hyjë në fuqi në datën në të cilën **Ndërrimi i Furnizuesit** bëhet efektiv.
- 2.9 **Kundërshtimi i Ndërrimit të Furnizuesit** - është njoftim i dorëzuar nga **Furnizuesi i Deritashëm** si kundërshtim për ndërrim të **Sistemit Matës** të **Furnizuesi i Ri**.
- 2.10 **Ndërrimi i Furnizuesit** - është proces nëpërmes të cilit një **Konsumator Fundor, Familjar** ose **Jofamiljar** e ndërron **Furnizuesin** e tij.
- 2.11 Të gjitha termet tjera në **bold** do të kenë kuptimin e njëjtë sikurse termet e përdorura në legjislacionin në fuqi, në licencë ose në **Rregullat e Tregut** sipas rastit.

3. Rasti i rregullt i Ndërrimit të Furnizuesit

3.1 Pas negocimit të një **Kontrate** të re për **Furnizim** ndërmjet **Konsumatorit** dhe **Furnizuesit të Ri**, **Konsumatori** duhet ti ofrojë **Furnizuesit të Ri** të gjitha informatat e kërkuara me qëllim të realizimit të **Ndërrimit të Furnizuesit**. Këto informata do të përfshijnë:

- a) identitetin e **Konsumatorit**;
- b) identitetin e **Operatorit të Rrjetit** përgjegjës për **Sistemin Matës** që është subjekt i ndryshimit të **Furnizuesit**;
- c) kodin numerik të identifikimit të **Sistemit Matës**;
- d) emërtimin e **Furnizuesit të Deritashëm** dhe periodën e vlefshmërisë së kontratës së përmbyllur ndërmjet **Konsumatorit** dhe **Furnizuesit të Deritashëm**;
- e) Një autorizim me shkrim për **Furnizuesin e Ri** për të kryer procedurën e ndërrimit në emër të **Konsumatorit**, duke përfshirë edhe ndërprerjen e kontratës për **Furnizim** me **Furnizuesin e Deritashëm**.

3.2 Pas pranimit të të gjitha informatave të kërkuara, **Furnizuesi i Ri** dhe **Konsumatori** mund të përmbyllin një **Kontratë** të re për **Furnizim**.

3.3 Pas përmbylljes së një **Kontrate** në përputhje me paragrafin 3.2, me kërkesë të **Furnizuesit të Ri**, **Operatori i Rrjetit** relevant brenda dy (2) **Ditëve të Punës** pas pranimit të kërkesës, do të siguroj **Furnizuesit të Ri** të dhënat e nevojshme (nëse ato nuk janë publike) në lidhje me **Ndërrimin e Furnizuesit** në përputhje me paragrafin 3.4 a) të kësaj **Rregulle**.

3.4 Pas pranimit të të gjitha informatave të kërkuara në përputhje me paragrafin 3.2 dhe 3.3, **Furnizuesi i Ri** dorëzon njoftimin për **Ndërrimin e Furnizuesit te AAM**:

- a) të dhënat e mëposhtme të nevojshme për **AAM** për validimin e njoftimit për **Ndërrimin e Furnizuesit**:
 - (i) identitetin e **Operatorit të Rrjetit** përgjegjës për **Sistemin Matës** që është subjekt i **Ndërrimit të Furnizuesit**;
 - (ii) Numrin referent Unik të **Njehsorit (NUNj)**, që i caktohet nga **Operatori i Rrjetit** relevant;
 - (iii) Numrin Referent të **Sistemit Matës** tek i cili është i caktuar **Njehsori**
 - (iv) **Drejtimin e Rrjedhave**;
 - (v) statusin e **Njehsorit (Njehsor me Lexim Interval apo Njehsor me Lexim Jo-interval)**;

- b) emërtimin e Furnizuesit të Deritashëm dhe Datën e Ndërrimit të Furnizuesit të propozuar, e cila nuk duhet të jetë më pak se njëzetë (20) Ditë Pune nga data e njoftimit; dhe
 - c) garantojë Operatorin e Tregut se posedon (ose do të posedojë në Datën e Ndërrimit të Furnizuesit) Kontratën për Furnizimin e Konsumatorit.
- 3.5 Brenda dy (2) **Ditëve të Punës** nga pranimi i njoftimit të dorëzuar në përputhje me paragrafin 3.4, **AAM** do të kontrolloj nëse të dhënat e dërguara në njoftimin për **Ndërrimin e Furnizuesit** janë të plota dhe të sakta. Nëse njoftimi për **Ndërrimin e Furnizuesit** është i vlefshëm, **AAM** do të njoftojë **Furnizuesin e Deritashëm** dhe **Furnizuesin e Ri** për vlefshmërinë e njoftimit për **Ndërrimin e Furnizuesit**.
- 3.6 Në qoftë se të dhënat në njoftimin për **Ndërrimin e Furnizuesit** nuk janë të plota dhe të sakta, brenda dy (2) **Ditëve të Punës** nga pranimi i njoftimit në përputhje me paragrafin 3.4, **AAM** do të njoftojë **Furnizuesin e Ri** për mangësitë në njoftimin për **Ndërrimin e Furnizuesit** dhe kohën në të cilën duhet të korrigjohen. **Furnizuesi i Ri** do të korrigjoj mangësitë brenda një (1) **Dite të Punës** nga pranimi i njoftimit nga **AAM**.
- 3.7 Në qoftë se njoftimi për **Ndërrimin e Furnizuesit** është për **Sistemin Matës** që është i shkyçur ose në proces të shkyçjes në përputhje me nenin 52, paragrafin 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, **AAM** do ta njoftojë **Furnizuesin e Ri**.
- 3.8 Në qoftë se brenda pesë (5) **Ditëve të Punës** nga pranimi i njoftimit të dorëzuar në përputhje me paragrafin 3.7, nuk është pranuar ndonjë njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit**, atëherë **Ndërrimi i Furnizuesit** bëhet i pakushtëzuar.
- 3.9 Në qoftë se nuk është pranuar ndonjë njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** në përputhje me paragrafin 3.8, brenda dy (2) **Ditëve të Punës**, **AAM** do ta njoftojë **Furnizuesin e Ri**, **Furnizuesin e Deritashëm**, **Operatorin e Tregut** dhe **Operatorin e Rrjetit** relevant për **Datën e Ndërrimit të Furnizuesit**.
- 3.10 **Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga ana e **AAM** në mënyrë që të reflektojë faktin se **Furnizuesi i Ri** do të jetë **I Regjistruari**.
- 3.11 **Operator i Tregut** do të sigurohet që **Të Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant, do të përdoren në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar** në **Llogarinë e Furnizuesit të Ri** nga **Data e Ndërrimit të Furnizuesit**.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të shkurtër për afatet kohore, respektivisht dërgim/pranimin e dokumenteve kur **AAM** nuk ka pranuar një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit**.



Veprimet/Dokumentet	Furnizuesi i Ri D-Dërgon P-Pranon	AAM D-Dërgon P-Pranon	Furnizuesi i Deritashëm D-Dërgon P-Pranon	Operatori i Rrjetit D-Dërgon P-Pranon	Operatori i Tregut D-Dërgon P-Pranon	Afati kohorë së paku X Ditë Pune para Datës së hyrjes në fuqi
Dorëzon kërkesat në lidhje me Ndërrimin e Furnizuesit dhe të gjitha informatat e kërkuara në përputhje me paragrafin 3.4.a).	P			D		21
Dorëzon të gjitha informatat e kërkuara duke përfshirë dhe autorizimet e nevojshme në përputhje me paragrafin 3.4.	D	P				20
Kontrollon nëse të dhënat e dërguara janë të plota dhe të sakta. Në qoftë se ato nuk janë të plota dhe të sakta, AAM do ta njoftoj Furnizuesin e Ri për të dhënat jo të sakta.	P	D				18
Dorëzon të dhënat e korrigjuara.	D	P				17
Në qoftë se të dhënat e dorëzuara në përputhje me paragrafin 3.4, janë të plota dhe të sakta, AAM do ta njoftojë Furnizuesin e Deritashëm dhe Furnizuesin e Ri për vlefshmërinë e njoftimit për Ndërrimin e Furnizuesit .	P	D	P			15
Nuk ka njoftim për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit .		P	D			10
AAM dërgon njoftimin që Furnizuesi i Ri do të jetë I Regjistruari dhe Datën e Ndërrimit të Furnizuesit .	P	D	P	P	P	8



4. Njoftimi për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit

- 4.1 Brenda pesë (5) **Ditëve të Punës** nga pranimi i njoftimit të referuar në paragrafin 3.7, **Furnizuesi i Deritashëm** mund ti dorëzoj **AAM** një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** nëse **Konsumatori** ka dështuar të përmbush detyrimet e tij sipas nenit 36, paragrafit 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- 4.2 Në qoftë se **AAM** pranon një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** brenda kohës së specifikuar, atëherë **AAM** brenda dy (2) **Ditëve të Punës**, do ta njoftoj **Furnizuesin e Ri** për pranimin e njoftimit për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** duke dhënë arsyet e caktuara në njoftimin për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit**.
- 4.3 **Furnizuesi i Deritashëm** i cili e ka dorëzuar një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit**, në çdo kohë mundet ta njoftojë **AAM** se dëshiron ta tërheqë njoftimin për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** të referuar në paragrafin 4.1 dhe **AAM** pastaj do ta njoftojë **Furnizuesin e Ri** se njoftimi për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** më tutje nuk është në fuqi.
- 4.4 Në qoftë se, pas tetë (8) **Ditëve të Punës** nga pranimi i njoftimit në përputhje me paragrafin 3.7, ekziston një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** i cili ende nuk është tërhequr atëherë propozimi do të anulohet, në të kundërtën do të bëhet i pakushtëzuar.
- 4.5 Brenda dy (2) **Ditëve të Punës** pas datës kur propozimi i bërë në përputhje me paragrafin 3.4 bëhet i pakushtëzuar, **Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga **AAM**, ashtu që të reflektoj faktin se **Furnizuesi i Ri** do të jetë **I Regjistruari** nga fillimi i asaj date dhe **AAM** do të njoftojë **Furnizuesin e Ri, Furnizuesin e Deritashëm, Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Rrjetit** relevant për **Datën e Ndërrimit të Furnizuesit**.
- 4.6 Me pranimin e njoftimit referuar në paragrafin 4.5, **Operatori i Tregut** do të sigurohet që të **Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant do të përdoren në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar** në **Llogarinë e Furnizuesit të Ri** nga data e referuar në atë njoftim.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të shkurtër për afatet kohore, respektivisht dërgim/pranimin e dokumenteve kur **AAM** ka pranuar një njoftim për **Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit** dhe më vonë kundërshtimi është tërhequr.



Veprimet/Dokumentet	Furnizuesi i Ri D-Dërgon P-Pranon	AAM D-Dërgon P-Pranon	Furnizuesi i Deritashëm D-Dërgon P-Pranon	Operatori i Rrjetit D-Dërgon P-Pranon	Operatori i Tregut D-Dërgon P-Pranon	Afati Kohor së paku X Ditë Pune para Datës së hyrjes në fuqi
Dorëzon kërkesat në lidhje me Ndërrimin e Furnizuesit dhe të gjitha informatat e kërkuara në përputhje me paragrafin 3.4.a).	P			D		21
Dorëzon të gjitha informatat e kërkuara duke përfshirë dhe autorizimet e nevojshme në përputhje me paragrafin 3.4.	D	P				20
Kontrollon nëse të dhënat e dërguara janë të plota dhe të sakta. Në qoftë se nuk janë të plota dhe të sakta, AAM do ta njoftoj Furnizuesin e Ri për të dhënat jo të sakta.	P	D				18
Dorëzon të dhënat e korigjuara.	D	P				17
Në qoftë se të dhënat e dorëzuara në përputhje me paragrafin 3.4, janë të plota dhe të sakta, AAM do ta njoftojë Furnizuesin e Deritashëm dhe Furnizuesin e Ri për vlefshmërinë e njoftimit për Ndërrimin e Furnizuesit .	P	D	P			15
Dërgon njoftimin për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit duke i dhënë arsyet për kundërshtim.		P	D			10
Dërgon njoftimin për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit duke i dhënë arsyet për kundërshtim dhe identitetin e Furnizuesit të Deritashëm .	P	D				8
Dërgon njoftimin për tërheqjen e njoftimit për Kundërshtim të Ndërrimit të Furnizuesit .		P	D			7
AAM do ti njoftoj që Kundërshtimi i Ndërrimit të Furnizuesit nuk është më tutje në fuqi, që Furnizuesi i Ri do të jetë I Regjistruari dhe Datën e Ndërrimit të Furnizuesit .	P	D	P	P	P	5



5. Kontestet

- 5.1 **Furnizuesi i Ri** dhe **Furnizuesi i Deritashëm** kanë të drejtë të ankohen tek **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE)**.
- 5.2 Në qoftë se **ZRrE** në lidhje me ankesën sipas paragrafit 5.1, vendos që **Furnizuesi i Ri** ka të drejtë të jetë **I Regjistruar** për një **Sistem Matës** specifik dhe lëshon një njoftim ku kërkon realizimin e **Ndërrimit të Furnizuesit**, atëherë **AAM** do të sigurohet që **Ndërrimi i Furnizuesit** të bëhet në datën e caktuar nga **ZRrE** dhe do t'i njoftojë **Palët** relevante për atë se **Ndërrimi i Furnizuesit** është bërë i pakushtëzuar në përputhje me paragrafin 4.4.
- 5.3 **Data e Ndërrimit të Furnizuesit** do të jetë data e caktuar nga **ZRrE**.
- 5.4 Në qoftë se **ZRrE** në lidhje me ankesën sipas paragrafit 5.1, vendos që **Furnizuesi i Deritashëm** ka të drejtë në ankesën e tij, atëherë **AAM** do të sigurohet që vendimi i **ZRrE-së** do të ekzekutohet dhe do t'i njoftojë **Palët** relevante.
- 5.5 Shqyrtimi i kontesteve do të bëhet duke pasur parasysh **Ligjin për Energjinë Elektrike** neni 36, paragrafi 7.

6. Ndërrimi i Furnizuesit në rastet e bankrotimit ose likuidimit të Furnizuesit të Deritashëm

- 6.1 Në rastet e bankrotimit ose likuidimit të **Furnizuesit të Deritashëm**, **Konsumatorët** që ngelin pa **Furnizues** do të **Furnizohen** nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit**, ndërsa **Data e Ndërrimit të Furnizuesit** do të konsiderohet data e suspendimit të furnizimit të **Furnizuesit të Deritashëm**.
- 6.2 **Furnizuesi i Deritashëm** është i obliguar të njoftoj (në përputhje me nenin 21.2 të **Rregullave të Tregut**) **Furnizuesin e Mundësisë së Fundit**, **Konsumatorin**, **ZRrE-në**, **AAM**, **Operatorin e Tregut** dhe **Operatorin e Rrjetit** relevant për datën e suspendimit të **Furnizimit**, brenda dy (2) **Ditëve të Punës** pasi të jetë i informuar për datën efektive, pas së cilës **Furnizuesi i Deritashëm** nuk do të jetë në gjendje të **Furnizojë** energjinë elektrike tek **Konsumatori**.
- 6.3 Brenda tri (3) **Ditëve të Punës** pas pranimit të njoftimit nga **Furnizuesi i Deritashëm**, **Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga **AAM**, ashtu që të reflektoj faktin se **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** do të jetë **I Regjistruari**. **Operatori i Tregut** do të sigurohet që të **Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant do të përdoren në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar** në **Llogarinë e Furnizuesit e Mundësisë së Fundit** nga data e referuar në atë njoftim.
- 6.4 **Furnizimi i Garantuar** nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë (referuar në nenin 39, paragrafit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike) nga data e ushtrimit të së drejtës për **Furnizim të Garantuar** sipas nenit 39, paragrafit 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
- 6.5 Në rast se **Konsumatori** që është **Furnizuar** nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** dështon të hyjë në marrëveshje me **Furnizuesin e Ri** brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 6.4, atëherë, **Operatori i Rrjetit** relevant do ta ndërpresë **Furnizimin** e tij me energji elektrike, sipas nenit 39, paragrafit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.



7. Ndërrimi i Furnizuesit në rastet e revokimit të Licencës

- 7.1 Në rastet kur **Licenca e Furnizuesit të Deritashëm** është revokuar përkohësisht, apo në mënyrë të përhershme, apo ka pushuar së vlejtori, atëherë **ZRrE**, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur **Licenca** në fjalë ka pushuar të vlejë, ose nga hyrja në fuqi e vendimit të **ZRrE**-së për revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të **Licencës**, do ta informoj **Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, Konsumatorin, AAM, Operatorin e Tregut, Furnizuesin e Deritashëm dhe Operatorin e Rrjetit** relevant, për vendimin e **ZRrE**-së dhe për datën e **Ndërrimit të Furnizuesit tek Furnizuesi i Mundësisë së Fundit**.
- 7.2 **Data e Ndërrimit të Furnizuesit** do të jetë data kur revokimi i **Licencës** me vendim të **ZRrE**-së ose ndryshe pushimi i mbetjes në fuqi, bëhet përfundimtar.
- 7.3 Brenda tri (3) **Ditëve të Punës** pas pranimit të njoftimit nga **ZRrE, Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga **AAM**, ashtu që të reflektoj faktin se **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** do të jetë **I Regjistruari. Operatori i Tregut** do të sigurohet që të **Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant do të përdoren në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar në Llogarinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit** nga data e referuar në atë njoftim.
- 7.4 Në rastet e revokimit të **Licencës së Furnizuesit të Deritashëm**, kohëzgjatja e **Furnizimit të Garantuar** nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** për **Konsumatorin** do të jetë në përputhje me paragrafin 6.4, ndërsa ndërprerja e **Furnizimit të Garantuar** të tij me energji elektrike do të bëhet në përputhje me paragrafin 6.5 të kësaj **Rregulle**.

8. Ndërrimi i Furnizuesit në rastet kur Konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e Furnizuesit të Ri

- 8.1 Nëse **Konsumatori** nuk arrin të ndërrojë **Furnizuesin e Deritashëm** në përputhje me paragrafin 1.4, atëherë **Konsumatori** jo më vonë se pesë (5) **Ditë Pune**, para datës së **Ndërrimit të Furnizuesit** në përputhje me paragrafin 1.4, ose para datës së ndërprerjes së kontratës me **Furnizuesin e Deritashëm**, **Konsumatori** duhet të dorëzoj te **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** aplikacionin në formën e publikuar nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit**.
- 8.2 Brenda dy (2) **Ditëve të Punës** nga pranimi i aplikacionit referuar në paragrafin 8.1, **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit**, do t'i njoftoj **AAM, Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Rrjetit** relevant.
- 8.3 Brenda tre (3) **Ditëve të Punës** pas pranimi të njoftimit nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** në përputhje me paragrafin 8.2, **Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga **AAM**, ashtu që të reflektoj faktin se **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** do të jetë **I Regjistruari. Operatori i Tregut** do të sigurohet që të **Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant do të përdoren në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar** në **Llogarinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit** nga data e referuar në atë njoftim.
- 8.4 Në rastet kur **Konsumatori** ka dështuar në zgjedhjen e **Furnizuesit të Ri**, kohëzgjatja e **Furnizimit të Garantuar** nga **Furnizuesi i Mundësisë së Fundit** për **Konsumatorin** do të jetë në përputhje me paragrafin 6.4, ndërsa ndërprerja e **Furnizimit të Garantuar** të tij me energji elektrike do të bëhet në përputhje me paragrafin 6.5 të kësaj **Rregulle**.

(Fundi i dokumentit)